

RAPORT TEKNIK

PROJEKTI: “FERME PER RRRITJE SHPENDESH 1- KAT”



Dokumentacioni hartohet mbi baze ligjore:

- **Referuar VKM Nr 828 date 28.12.2023, per disa ndryshime dhe shtesa ne VKM Nr. 686, date: 29.7.2015, "Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis dhe procedures se transferimit te vendimit e deklarates mjedisore" Kreu II.**
- **Ligjit Nr. 12/2015 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis"; Shtoja I, klasifikohet si aktivitet që i nënshtrohet Procedures se thelluar te Ndikimit ne Mjedis. Specifikisht klasifikohet ne: Shtojca I, pika 17. Instalime për mbarëshkrimin intensiv të pulave ose derrave me mbi: a) 1000 krere per pulat qe rriten per mish**

Investitor/Pronar: Armand Kuka & Najada Kuka

NUIS: K82811403M

Adm: Armand Kuka

Vendodhja: Kurjan, Bashkia Roskovec

Raporti Teknik u pergatit nga Eksperti Mjedisit:

Ing. Ermelinda AGALLIU
NUIS: L73404408G

Pasqyra e lendes:

- a) qellimin e projektit te propozuar;
- b) planimetrine e vendndodhjes se projektit, ku te pasqyrohen ne harte topografike kufijte e siperfaqes, te shoqeruar me koordinatat, sipas sistemit koordinativ Gauss Kruger, fotografi dhe te dhena per perdorimin ekzistues te siperfaqes qe do te perdoret perkohesisht apo perhere nga projekti, gjate fazes se ndertimit apo funksionimit te veprimtarise;
- c) informacionin per qendrat e banuara, ne zonen ku propozohet te zbatohet projekti, shoqeruar me fotografi dhe te dhena per distancen e tyre nga vendndodhja e projektit te propozuar, si dhe percaktimin e njesise se qeverisjes vendore qe administron territorin ku propozohet projekti;
- ç) skicat dhe planimetrite e objekteve dhe strukturave te projektit si dhe menytrat dhe metodat qe do te perdoren per ndertimin e objekteve dhe strukturave te projektit;
- d) pershkrimin e proceseve ndertimore dhe teknologjike,perfshire kapacitetet prodhuese / perpunuese, sasite e lendeve te para dhe produktet perfundimtare te projektit;
- dh) informacionin per infrastrukturen e nevojshme per lidhjen me rrjetin elektrik, fumizimin me uje, shkarkimet e ujerave te ndotura dhe mbetjeve, si dhe informacionin per rruget ekzistuese te aksesit apo nevojen per hapje te rrugeve te reja;
- e) programin per ndertimin, kohezgjatjen e ndertimit, kohezgjatjen e planifikuar per funksionimin e projektit, kohen e mundshme te perfundimit te funksionimit te projektit dhe, sipas rastit, edhe fazen e planifikuar te rehabilitimit te siperfaqes, pas mbarimit te funksionimit te projektit;
- ë) lendet e para qe do te perdoren per ndertimin dhe menytra e sigurimit te tyre (materiale ndertimi, uje dhe energji);
- f) informacionin per lidhjet e mundshme te projektit me projekte te tjera ekzistuese perreth/prane zones se projektit;
- g) informacionin per alternativat e marra ne konsiderate, per sa i takon perzgjedhjes se vendndodhjes se projektit dhe teknologjise qe do te perdoret;
- gj) te dhenat per perdorimin e lendeve te para gjate funksionimit, perfshire sasite e ujit te nevojshem, te energjise, lendeve djegese dhe rrenyren e sigurimit te tyre;
- h) aktivitete te tjera qe mund te nevojiten per zbatimin e projektit, si ndertimi i kampeve apo rezidencave etj.;
- i) informacionin per lejet, autorizimet dhe licencat e nevojshme per projektin, ne perputhje me percaktimet e bera ne legjislacionin ne fuqi, si dhe institucionet kompetente per lejimin, autorizimin, licencimin e projektit;
- j) kopje te lejeve, autorizimeve dhe licencave qe disponon zhvilluesi per projektin e propozuar, ne perputhje me percaktimet e bera ne legjislacionin ne fuqi, si dhe institucionet kompetente per lejimin, autorizimin, licencimin e projektit.

a) Përshkrimin e qëllimit të projektit të propozuar

Raporti I Nderveprimit me mjedisin është bere me kerkese te z. Armand Kuka per projektin ne studim “Ferme per rritjen e shpendeve 1-kat”, projekt I cili ndodhet ne zonen kadastrale 2336, e ndodhur ne fshatin Kurjan, Bashkia Roskovec, e treguar si me poshte:

Elementet funksionale jane:

- Objekti kryesor ku do zhvillohet procesi
- Parkim i mjeteve dhe shesh per qarkullim
- Instalimi I sillosave pas objektit
- Shesh I lire per nevoja te mevonshme.

Objekti yne ne studim do te sherbeje vetem per rritjen e shpendeve, ata do te merren te vegjel (zogj) dhe do te rriten ne objektin tone deri ne fazen e pergatitjes se tyre per dergimin ne fabrika te ndryshme te thertoreve (per mish) sipas kerkesave te tregut (proces I cili nuk do te kryhet ne kete objekt). Ky projekt mendohet te kete nje impakt pozitiv ne treg duke bere te mundur nje punesim te perhershem apo edhe te perkohshem te zonave perreth fshatit te Kurjanit ne Bashkine Roskovec.



Zona ne te cilen eshte projektuar objekti ndodhet ne fshatin Kurjan, Bashkia Roskovec. Ajo pozicionohet pergjate nje rruge rurale qe sherben per nevojat e fermereve dhe bizneseve te zones. Prona ka nje siperfaqe totale disponibel prej 1870 m². Sipas Planit te Pergjithshem Vendor te Bashkise Roskovec miratuar me vendim te KKTse Nr.4, Dt. 10/06/2020, kjo zone i perket sistemit bujqesor. Zona eshte e mireformuar me infrastrukture te plote rugore, te rrjetit ujesjelles, kanalizimeve, elektrikut dhe telefonise. Kjo zone eshte nje zone e pasur me toka bujqesore ku kryesisht gjenden te mbjella peme ulliri pasi eshte ne nje pozicion te favorshem per tu shfrytezuuar per bujqesi e blegtori. Te gjithë zonat/fshatrat rreth Roskovecit jane zona ku rralle gjenden toka te paperdorshme, ndaj dhe z. Armand Kuka ka menduar zhvillimin e prones se tij per ngritjen e nje objekti 1 kat per rritjen e zogjve deri ne nje peshe te caktuar dhe per ti derguar me pas ne thertore (tjertorja nuk eshte pjese e ketij projekti) nga ku do te tregtohen per mish. Eshte menduar instalimi I nje kapaciteti prej 12000 zogj qe rriten per mish.


Faza e projektimit

Respektivisht per projektin **“Ferme per rritjen e shpendeve 1-kat”** me nje siperfaqe te shfrytezueshme toke prej 1870 m2 Magazina qe do te ndertohej do te kete nje siperfaqe prej 301.4 m2 dhe me nje lartesi te shfrytezueshme 5.5 m. Objekti eshte projektuar per te pasur nje ambjent higjienik dhe lehtesisht te pastrueshem per te parandaluar ndotjen e objektit ne teresi por edhe per qarkullimin e lirshem brenda tij per levizjen e punonjesve. Kjo redukton rrezikun nga ndotja dhe ul mundesine e aksidenteve midis punetoreve te cilet mund te perplasen duke levizur gjate procesit. Per te gjitha fazat e procesit eshte siguruar hapësira e nevojshme e funksionimit.

Ne fazen e projektimit jane marre parasysh te gjithe elementet e nevojshem per hartimin e nje projekti sipas kuadrit ligjor dhe kerkesave te investitorit per ndertimin e nje objekti sipas projektit qe ai ka menduar te ndertoje duke parashikuar te gjitha kushtet sipas standarteve dhe hapësirën e nevojshme qe do ti duhet ketij objekti pas perfundimit te procesit te ndertimit.

b) **planimetrinë e vendndodhjes së projektit**, ku të pasqyrohen në hartë topografike kufijtë e sipërfaqes, të shoqëruar me koordinatat sipas sistemit koordinativ GAUS KRUGER, fotografi dhe të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes që do të përdoret përkohësisht apo përherë nga projekti, gjatë fazës së ndërtimit apo funksionimit të veprimtarisë.

Njesia Strukturore e zones paraqitur si me poshte:



Referuar projektit arkitekturor, me poshte jepen te dhena teknike:

Treguesit e zhvillimit te propozuar:

Referuar projektit arkitekturor, me poshte jepen te dhena teknike:


Treguesit e zhvillimit te propozuar:

Sipërfaqja e truallit që zhvillohet: 1870 m2

Sipërfaqja e truallit e zënë nga struktura: 301.4 m2

Sipërfaqja totale e ndërtimit mbi tokë: 301.4 m²
 Siperfaqja e tokes ne perdorim te objektit: 506.3 m²
 Koeficienti i shfrytezimit te truallit: 16.1 %
 Lartësia maksimale e strukturës: 5.5 m
 Numri i kateve mbi toke: 1
 Numri i pasurise: 153/21
 Zona Kadastrale: 2336
 Adresa: Fshati Kurjan, Bashkia Roskovec

Parcela e cila do te perdoret per ndertimin e objektit eshte nje parcele e pashfrytezuare me pare, aty gjenden vetem barishte apo shkurre sic duken nga fotot ne terren. Pra pas ndertimit te objektit per funksionin e permendur me siper do te beje te mundur zhvillimin e kesaj zone si dhe te ofroje ne treg pula te cilat do te tregtohen per mish.




Kufijte e prones ne studim

Koordinatat gjeografike sipas sistemit Gauss-Kruger

Nr	X	Y
1	479432.731	4509288.873
2	479446.619	4509287.081
3	479456.475	4509291.113
4	479473.275	4509277.897
5	479502.619	4509239.145
6	479475.291	4509253.033
7	479444.155	4509243.177


**PLANI I VENDOSJES SË ZONËS QË ZHVILLOHET PËR STRUKTURËN:
" FERME PER RRRITJEN E SHPENDEVE 1-KAT ", NË KURJAN, BASHKIA ROSKOVEC.
PRONAR: " ARMAND KUKA DHE NAJADA KUKA", ZHVILLUES: " ARMAND KUKA".**



SKEMA E VENDOSJES SË ZONËS SË ZHVILLIMIT
SHKALLA 1:5000



POZICIONI KADASTRAL
ZONA KADASTRALE Nr.2338, Nr.pasurise. 153/21 SHKALLA 1:1000



**MIRATOHET
KRYETARI I BASHKISË
MAJLINDA BUFI**

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

EMËRTIMI I PUNIMEVE: FERME PER RRRITJEN E SHPENDEVE 1-kat
KATEGORIA E PËRDORIMIT TË TOKËS: Are
LLOJI I STRUKTURËS SE RE: Metalike
PRONARI: Armand Kuka dhe Najada Kuka
ZHVILLUESI: Armand Kuka
Kurjan, BASHKIA Roskovec
Njesia RO_B_18/86
Sistemi: B.Bujqesor

TREGUESIT E ZHVILLIMIT TË PROPOZUAR

SIP. E TOKËS QË ZHVILLOHET	1870m2
SIP. E TOKËS E ZËNË NGA STRUKTURA	301.4m2
SIP. E TOKËS NE PERDORIM TE OBJEKTIT	506.3m2
SIP. E PËRGJITHSHME E NDËRTIMIT	301.4m2
LARTËSIA MAKSIMALE E STRUKTURËS NGA NIVELI +/-0.00	5.5m
NUMRI I KATEVE MBI TOKË	1 kat
NUMRI I KATEVE NËN TOKË	-
KOEF I SHFRITËZIMIT TE TRUALLIT	16.1%
INTENSITETI I NDËRTIMIT (në ndërtim/ha pronë SIPAS VLM-ave 283)	0.76 < 1
VËLLIMI I STRUKTURËS JABI TOKË	1432.8 m3

TREGUESIT E DISTANCAVE

NGA KUFJTË E PRONËS: V: 12.3m ; J: 7m ; L: 12m ; P: 7m ;

NGA STRUKTURAT E TJERA: V: - ; J: - ; L: - ; P: - ;

NGA RRJETI RRUGOR: V: - ; J: - ; L: 12m ; P: - ;

NGA SERVIDUTET PUBLIKE: V: - ; J: - ; L: - ; P: - ;

REPUBLIKA E SHQIPERISE BASHKIA ROSKOVEC <small>DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE KONTROLLIT TE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT</small>			
Drejtues i Planifikimit dhe Kontrollit te Territorit			
Drejtues i Sektorit te Menaxhimit te Aplikimave			
Specialist i Gjeo-Kadastres			
Specialist i Planifikimit te Territorit			
Projektues	ark. Elton YOSKA top.Gezim HAZIZI	Lic. A-0840/2 Lic.T-0324/1	

Planimetria e vendndodhjes se projektit





Foto aktuale te prones sone ne studim


Parcela e cila do te perdoret per ndertimin e objektit eshte nje parcele e pa shfrytezuar, ku ndodhen te mbjella disa peme ne fund te prones te cilat nuk do te priten pasi nuk pengojne ne zhvillimin e projektit ne studim, pasi objekti qe do te zhvillohet ka nje siperfaqe prej 301.4 m². Pra pas ndertimit te objektit per funksionin e permendur me siper do te beje te mundur zhvillimin e kesaj zone si dhe te ofroje ne treg produkte pule te cilat do te rriten per mish. Fieri ka thertore pulash si dhe tregetim te mishit te pules ne shume rrethe ne Shqiperi ndaj edhe me rritjen e kerkesave per mish pule, investitori do te marre persiper kete investim per te mbuluar nevojat qe tregu ka per produkte te mishit te pules.

PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

PRONARI: ARMAND KUKA DATE 06/03/2024 QELLIMI (SHESH NDERTIMI)

VENDNDODHJA KURJAN
 BASHKIA ROSKOVEC DVASHK/ ZVASHK FIER ZONA KADASTRALE 2336 NUMRI PASURISE 153/21
 TE DHENAT E PASURISE INDEKSI HARTES K-34-112-(217-A)
 LLOJI PASURISE: ARE SIP.PASURISE= 1870 M2 SIP. GJURMES NDERTIMIT= M2 NUMRI I KATEVE KT NUMRI I PEMEVE

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPETARE



SH 1:500

Nr.	Orientimi	Perdorimi	Tipi kufirit	Kufitari	ID / Nipt	Shenime te realizuesit
1	VERI	RRUGE	.			
2	LINDJE	RRUGE	.			
3	JUG	153/17	.			
4	PERENDIM	153/22	.			

REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT

EMRI : GEZIM HAZIZI
 LISHENCA : NR.T0324/I DATE26.06.2017
 KOMPANIA STUDIO TOPOGRAFIKE FIERI

NIPT: K-92521-01-O

NENSHKRIMI/VULA _____

REALIZOI PER ASHK

SPECIALISTI

DVASHK

NENSHKRIMI

KONFIRMOI

PERGJEGJESI/DREKTORI

NENSHKRIMI/VULA _____

Gezim Hazizi
 Digital Signature
 Gezim Hazizi
 Date: 2024.03.06 11:08:11 +01'00'

TEKNOLOGJIA E MATJEVE T

Kode per teknologjine e matjeve : T-Terren ; O-Ortofoto ; G-GPS ; S-Station Total ; D- Matje Distancash

PERCAKTIMI KUFIRIT HK

Kode per percaktimin e kufirit : P - Perfaqesuesi i pronave ; K - Kufitaret te Gjithe ; Kp - Kufitaret Pjeserisht
 PB - Perfaqesues Bashkie ; HK - Harta Kadastrale

SHENIME TE VECANTA:

PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARDHENIET ME KUFITARET

EMRI _____

NENSHKRIMI _____

Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimin e kufirit : T-Terren ; O-Ortofoto ; G-GPS ; S-Station Total ; D - Matje Distancash ; P - Perfaqesuesi i pronave ; K - Kufitaret te Gjithe ; Kp - Kufitaret Pjeserisht PB - Perfaqesues Bashkie ; HK - Harta Kadastrale

Harta topografike e prones ne studim


- c) Informacionin për qendrat e banuara në zonën ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar me fotografi dhe të dhëna për distancën e tyre nga vendndodhja e projektit të propozuar, si dhe përcaktimin e njësisë së qeverisjes vendore që administron territorin ku propozohet projekti

Roskoveci eshte nje qender e vjeter, e banuar, e njohur fillimisht per nje kohe te gjate si "pazar". Ditet e djela aty grumbulloheshin shites dhe bleres nga krahina te aferta dhe te largeta per te tregtuar mallra te ndryshem duke filluar nga gjeja e gjalle e deri tek produktet me te imeta bujqesore e artizanale. Per ti sherbyer ketij pazari dhe njerezve te fshatrave perreth ishin ngritur dhe shume dyqane zanatçinjsh, kryesisht

Eshte dizenuar mbi bazen e konceptit "solar pasiv" duke pasur parasysh gjeometrine dhe parametrat e hapësirave te prodhimit.


- Mbulimi do te jete me ngjyre te bardhe te lehte per te reflektuar nje perqindje te madhe te energjise diellore duke cuar ne reduktim te konsumit energjistik dhe kontroll te temperaturave te brendshme. Kjo ngre rendimentin ne pune.
- Ne paretet anesore do te vendosen dritare ventiluese per te krijuar qarkullimin natyral te ajrit, nese do te jete e nevojshme eshte menduar edhe vendosja e disa ventilatoreve tavanore per te ndihmuar qarkullimin.
- Do te perdoren sisteme dhe pajisje qe kursejne energji aty ku eshte e mundur vendosja e tyre Ambjenti eshte projektuar:
- Bazuar ne nevojat aktuale dhe te mevonshme.
- Per lehtesimin e cfaredo lloji ndryshimi ne biznes/zgjerim aktiviteti apo sasi stafi/zyra apo hapësira te tjera brenda godines.
- I adaptueshem edhe ne rastet kur funksioni ndryshon teresisht.
- Qe hapësira e jashtme te plotesoje nevojat per qarkullimin e lirshem te mjeteve te furnizimit si dhe per parkim te perkohshem te tyre.
- Me strukture tavanore me rezerve strukture per perballimin e shtesave te mevonshme te pajisjeve apo ngarkesave.
- Me sistem mbrojtjeje kunder zjarrit i nevojshem per sigurine e materialeve me rrezik te larte ndezjeje.
- Per maksimizim te perdorimit te hapësires se brendshme duke siguruar edhe hapësire qarkulluese per personelin (dhe pirunin ngrites).
- Per arritshmeri te mire te portave komunikuese per ngarkim-shkarkimin e mallit si dhe ne zonen e manovrimit te kamioneve.
- Dhe llogaritur per mbulim dhe veshje anesore kundrejt efekteve natyrale si shiu, era apo lekundjet sizmike.
- Qe te kete nje dyshemeje rezistente ndaj gerryerjes, rreshkitjes dhe peshave te renda duke dhene pjerresite e duhura per mbledhjen e ujit.
- Qe niveli i dyshemesë te jete 15cm mbi nivelin e sheshit dhe lidhjen e krijojme me rampa te pershtatshme per levizje te panderprere nga brenda jashte dhe anasjelltas.
- Dimensionet e dyerve jane 180cm x 220cm ne 550cm x 400cm per te siguruar funksionim te plote pajisjeve shkarkuese/ngarkuese.

Plani i Organizimit te Objektiv "FERME PER RRRITJEN E SHPENDEVE" ne Kurjan, Bashkia Roskovec




Planimetria e objektit (kuota +/-0.00)
SKEMA E FERMES

sh.1:150



Planimetria e objektit ne kuoten 0.00



OBJEKTI:		
FERME PER RRIJTJEN E SHPENDEVE		
KURJAN, BASHKËSI RROGHOVIC		Shkalla
DOKUMENTI I FLETES:		1:150
Planimetria e mbulimit		
ARKITEKTI:	ELBON TOSKA	
ING. KODITI:	RF.IG. N-8846/2	
DRAJTLIUESI: ARMAND KUKA		A-03


Plani I mbulimit te objektit

Prerja a-a




LLOGARITJA E VOLUMIT SIPAS SEKSIONIT

Sip. Seksioni = 70.9 M2
 Gjatesia e Objektivit = 20.2 ML
 Volumi = 1432.8 M3 < 1870 M3 < 1




OBJEKTI:		
FERME PER RRITJEN E SHPENDEVE		
KURSI, BASHKIA ROSHONJEC		Shkalla 1:150
EMERTIMI I FLETES: Prerja a-a		
ARHITEKT:	Elton TOBKA R.F.C. N-2842/2	
ING. KOSTR:		
ZHARRUESI:	ARMAND KUKA	A-04

Fasada Lindje




Fasada Perendim



OBJEKTI:		
FERME PER RRITJEN E SHPENDEVE		
KURSI, BASHKIA ROSHONJEC		Shkalla 1:150
EMERTIMI I FLETES: Fasadat e Objektivit		
ARHITEKT:	Elton TOBKA R.F.C. N-2842/2	
ING. KOSTR:		
ZHARRUESI:	ARMAND KUKA	A-05

Fasade e objektit

Imazhe 3D te Objektivit



Pamje te projektit te propozuar

d) Përshkrimin e proceseve ndërtimore dhe teknologjike, përfshirë kapacitetet prodhuese / përpunuese, sasi të lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit;

NDERTESA

Me një sipërfaqe të shfrytëzueshme prej 301.4m² dhe me një lartësi të shfrytëzueshme 4.0 m (5.5m total), objekti është projektuar për të pasur një ambient higjienik dhe lehtësisht të pastrueshem.

Brenda ndërtesës produkti leviz hap pas hapi në një proces të vazhduar linear. Kjo redukton rrezikun nga ndotja dhe ul mundësinë e aksidenteve midis punëtorëve të cilët mund të perplasen duke levizur gjatë procesit. Për të gjitha fazat e procesit është siguruar hapësira e nevojshme e funksionimit.

MBULIMI DHE TAVANI

Mbulimi i ndërtesës nga sipër do bëhet me panel termoizolues me 5 kreshta, trashësia e të cilit do të jetë 40 mm. Vendoset me një pjerrësi 12% (6°) duke sjelle ujërat në jug ku do vendoset ulluku horizontal e me pas ata vertikale.



PANEL ME 5 KRESHTA PER MBULIM KAPANONI I PERBERE NGA POLIURETAN I PRESUAR ME

DENISTET TOTAL : 40 ± 4 KG./m³

STABILITET DIMENSIONAL : MAX. 1% NGA -25°C NE + 70°C SIPAS NORMES UNI 8069

TEMPERATURA PER PERDORIM : NGA -90°C NE + 80°C

PERCJELSHMERIA TERMIKE : 0,0216 W/mK


LLAMARINA: 0,4 MM NGA TE DY ANET

NGJYRA : RAL9002 (BARDHE E GRI) NGA JASHTE / RAL 9002 (BARDHE E GRI) NGA BRENDA MURET, DRITARET DHE DYERT

Veshja anesore e ndërtesës do bëhet pjeserisht me mur te vazhuar perimetral betonarme deri ne lartesine 40 cm nga niveli 0 per te krijuar nje mbrojtje nga proceset e punes dhe goditjet. Kolonat metalike IPE 240 do te jene ne pjesen e brendeshme te perimetrit veshes. Me pas vendoset konstruksioni metalik I mbajtjes (arkarexhat) se paneleve sanduic termoizolues me vide te fshehur, trashësia e të cilit do të jetë 40 mm. Teknologjia e montimit te tyre nuk lejon te cara apo diferenca te cilat ndikojne ne termoizolim dhe ne futjen e insekteve.

Panelet jane te lyera me boje me rezistence te larte e cila ndihmon pastrimin e shpejte dhe larjen me uje te rrjedhshem ne rastet e ndotjeve.

Ndricimi ditor, si ndricim i oreve me te ngarkuara te punes, sigurohet me ane te dritareve duke bere njekohesisht edhe ventilimin e hapesires ne rastet e motit te nxehte. Kjo ul edhe konsumin e energjise elektrike duke e bere sa me rentabel stabilimentin. Te gjitha dritaret pajisen me rrjeta mbrojtese insektesh dhe parvazet e tyre kane nje pjerresi te konsiderueshme per te mos lejuar akumulimin e pluhurave.



PANEL ANESOR ME LIDHJE MASHKULL-FEMER ME VIDE TE FSHEHUR PER VESHJE KAPANONI I PERBERE

NGA POLIURETAN I PRESUAR ME **DENISTET TOTAL: 40±4 KG./M.3 STABILITET**

DIMENSIONAL : MAX. 1%

NGA -25°C NE + 70°C SIPAS NORMES UNI 8069 **TEMPERATURA PER PERDORIM :**

NGA -90°C NE + 80°C

PERCJELSHMERIA TERMIKE : 0,0216 W/mK **LLAMARINA:** 0,4 MM NGA TE DY ANET

NGJYRA : RAL9006 (ARGJEND) NGA JASHTE / RAL 9002 (BARDHE E GRI) NGA BRENDA **DYSHEMEJA**

Dyshemeja do te realizohet me beton te markes se larte me finitura te lemuara pa carje dhe demtime te siperfaqjes. Cilesia e betonit lidhet me peshen te ciles duhet ti rezistojte kurse cilesia e finiturave lidhet me kujdesin ndaj acideve apo lendeve gerryerese te cilat me kalimin e kohes depozitohen neper te cara dhe krijon erozion.

Mendohet qe te perdoret Epoxy per lysterjen e dysHEMEVE, eshte rezistent ndaj substancave gerryese, trafikut te rende dhe pastrohhet lehte.

Per te lehtesuar pastrimin me uje te rrjedhshem dysHEMEJA do te marre pjerresite e nevojshme per te drejtuar ujerat ne kanalet drenuese te cilat do te mbulohen me rrjeta metalike lehtesisht te levizshme ne rastet e mirmbajtjeve apo avarie.

OBORRI JASHTEM

Kompleksi eshte menduar te funksionojte si nje hapesire e kontrolluar nga nje porte komunikuese nga rruga rurale qe ndodhet ne lindje te prones. Ambjenti do te rrethohet gardh mbrojtjes metalik me lartesi H-2m.

Hapesira eshte organizuar me godinen kryesore qe vendoset ne mes te prones per te krijuar hapesire parkimi/sherbimi perpara dhe pas si dhe hapesire sherbimi dhe te gjelber ne perimenter. Per shkak te pjerresise se terrenit do te behet tarracimi ne pjesen ku do te vendoset objekti dhe sherbimet e jashtme. Shtrimi i sheshit do te behet me beton.

DISTANCA NGA RRUGA

Distancat e projektit janë në përputhje me Ligjin dhe Rregulloren e Planifikimit. Rruga kryesore ndodhet në lindje të pronës. Prej saj hyet në sheshin para objektit e me tej në brendësi të pronës nëpërmjet rruges komunikuese me gjeresi 4m që kalon në veri.

PUNIME DHEU, GËRRMIME DHE THEMELET

Përgatitja e formacioneve,

Përgatitja e formacioneve përfshin këto punë:

- Njohja dhe saktësimi i rrjeteve të instalimeve nën tokë si p.sh: tuba të furnizimit të ujësjellësit, tuba të shkarkimit, kablllo elektrike e telefonie etj;
- Matja e terrenit dhe piketimi i objektit;
- Heqja e dheut me humus dhe ripërdorimi i saj në rast se është e mundur;
- Hapja e gropave të plintave deri në thellësinë e nevojshme referuar projektit inxhinierik.

Furnizimi me energji elektrike dhe ndricimi

Vendosja e një transformatori me fuqi të llogaritur 50kW do të bëjë të mundur furnizimin me energji elektrike të stabilimentit. Sistemi i shpërndarjes do të jetë nëntokësor për të lejuar qarkullim sa më të lehtë në sipërfaqje, për të shmangur aksidentet si dhe ndikimin nga moti. Ndricimi do të jetë Led, i afte për të kryer një shpërndarje të mirë të ndricimit, eficient në kursim energjie dhe me humbje minimale në rrjet. Ndricuesit do të jenë tavanore në pjesën e brendshme të godinës ndërsa për ndricimin e pjesës së jashtme ato do të montohen në trup të godinës dhe pjesërisht në murin rrethues.

Mbrojtja nga Zjarri

Mundësia e një zjarri nuk përjashtohet asnjehere sidomos në këto ambiente ku egzistojnë material lehtësisht të ndezshme. Është menduar që të vendosen 2 sete fikesesh zjarri me tym pasi ambienti është i vogël dhe i menaxhueshem për një kohë të shkurtër.

➤ Rrjeti inxhinierik.

Në objekt është linja ekzistuese për rrjetin inxhinierik (kanalizime, ujë i pijshëm, energji elektrike dhe internet) ku të gjitha këto lidhen me rrjetin e Bashkisë Roskovec.

➤ FURNIZIM ME UJË SANITAR

Pika e lidhjes për furnizimin me ujë të rrjetit të ujësjellësit. Vendosja e 1 cope rezervuareve uji me llamarine të zinguar V=1000 litra secili do të garantojë nevojat për ujë sanitar dhe zjarrefikes.

Instalimet e brendshme të ujit sanitar dhe zjarrefikes do të realizohen me tuba të zinguar me fileto P =16ATM. Të gjitha tubacionet përpara se të mashkohen të provohen nën presion dhe të termoizolohen. Vendet e kalimit të tubacioneve të lihen gjatë ndërtimit. Pjerresia e tubacionit do të jetë 5% në ngjitje të tubacioneve. Tubacionet e ujit në tavanin e varur të podrumit do të termoizolohen njëjllë me tubacionet e ngrohjes.

➤ SHKARKIMET E UJRAVE TË BARDHA DHE TË ZEZA

Pika e lidhjes për shkarkimin e ujrave të zeza të objektit do të jetë në gropën septike me volum 16 m³ të paraqitur në projekt.

Instalimet e jashtme dhe brendshme të shkarkimit të ujrave të bardha dhe të zeza do të realizohen me tuba pastmasi P = 16ATM me bashkim me gota me guarnicion të rekomanduar për këtë material.


Tubacionet jashtë godinës do të kemishohen me beton M – 100 në perimetrin 15 cm.

Për mbledhjen e ujrave të shiut të shiut të taracës të godinës do të perdoret tub pastmasi me P =3 ATM.

Të gjitha tubacionet horizontale të shkarkimit të ujrave të bardha dhe të zeza të nyjeve sanitare montohen në tavanin e varur të kapura me fasheta metalike. Të gjitha tubacionet vertikale të shkarkimit të ujrave të bardha dhe të zeza montohen në oxhakun të lenë për këtë qëllim (në fletet ndërtimore). Të gjitha kollonat inkastrohen në murin e oxhakut me fasheta metalike.

Të gjitha pusetat e kanalizimit të jashtëm do të ndërtohen me mure betoni dhe kapak gize.

VENTILIMI I W.C- ve



STUDIO PROJEKTIMI	
"MBETI NDRITIMI" Sh.p.ri nr.3a.0802 NR.KNPTLL72220403B ebt7@ndritimi.com	
Arkitekt	
Mirel BUCKA	
Ing.konstruktor	
Mirel BUCKA	
Ing.Hidroteknik	
Arqile SHISHKO	
Ing.Elektrike	
Klajdi ALLKAJ	
Sh.1:100	hs-02
FEMBE PER BIRZIEJE E SHPËRDEJE HROT PROVIM: JORANDI KAMA DHE INADRA KAMA KURJANI BASHKIPA ROSCOVEC (Skemat e furnizimit me uje)	
EMERTIMI PROJEKTIT	EMERTIMI FLETES

• Kriteret e perdorimit

Studimi per ndertimin e objektit eshte mbeshetur ne studimin e zones, ku respektohen te gjitha normativat e studimit te zones, ndertimi do te jete bashkekohor fasada moderne dhe do te jete ne harmoni me objektet perreth.

Ne objekt do te ngrihet nje kantier nderitimi i perbere nga:

- *shesh per depozitimin e materialeve te ndertimit si derrasat, skelat, cakulli, rere, zhavor etj
- *shesh per depozitimin dhe perzierjen e betonit
- *ambient per depozitimin e cimentos
- *shesh per vendosjen e mekanizmave, perzjeres beton, automjete transporti,
- *shesh i lire per operacione te llojeve te ndryshme.

Sistemet e ngrohje ftohjes qe do te perdoren ne stalle

Per krijimin e nje mikroklime sa me te pershtatshme per rritjen e shpendeve ose te kafsheve ne periudha te ndryshme te vitit si dhe per rritjen e ushqimit ne kushte optimale stalla ka nevojte per tu paisur me sistemen e ngrohjes qendrore qe do te realizohet nepermjet dy kaldajave, por ne ambientet e magazinimit te ushqimit mundte realizohet edhe nepermjet kondicionereve tip inverter. Stalla gjithashtu do te jete e paisur me radiatore per futjen e ajrit te paster, me sistem dritaresh me hapje automatike dhe ventilatore per largimin e ajrit te ndotur qe vihen ne pune po ne menyre automatike .

Ngrohja e ambienteve do te behet me uje te ngrohje me kaldaje gize me fuqi ngrohese Q=50 kw.

Lenda djegese e perdorur do te jete gaz i kenshem e cila do te sprucohet ne kaldaje nepermjet sprucatorit te naftes me G=60 kg/ore.

Instami i ngrohjes realizohet me tuba bakri .Tubacionet horizontale ,futen nen dysheme ne kanal per pjesen nje kateshe, Sistemi do te punoj me qarkullim te detyruar (me pompe) me dy tuba me furnizim nga poshte.Njera pompe do te jete rezerve.Kollonat vertikale te ngrohjes (dergimi dhe kthimi) do te maskohen sipas detajit ndertimor.

Tubacionet ne kanal, tubacinet ne tavan te varur dhe tubacionet vertikale do te termoizolohen. Pendentat e tubacioneve do te realizohen:

- a) Shtrirjet horizontale kane pjerresine P=5‰ duke u ulur ne drejtim te dhomes se kaldajes

b) Degezimet e radiatorëve që lidhen me kollonat kanë pejrresinë $P=1\%$ duke u ulur në drejtim të levizjes së ujit.

Ajrimi i sistemit të ngrohjes realizohet me ventila ajrimi të vendosur në radiatorët. Në uljet e theksuara të tubacioneve, në kulmet e sipërme të tyre do të instalohen ajer-nxjerrës automatik.

VO. Të respektohen me përpikëmeri instalimet sipas kushteve teknike të zbatimit në ndertesa ventilatorët për largimin e ajrit të piset do të jenë me përmasa 140 x 140 cm dhe do të jenë vendosur në fund të stales.

Shëndeti/Komforti

- Sigurimin e ventilimit të përshtatshëm në çfaredolloj rrethane të mundshme.

- Aspirim për tualetin dhe ambjentet e tjera të shërbimit.

- Në të ardhmen integrimin e sistemit të elektrifikimit me energji diellore.

- Lejimin e ndricimit natyral sa më shumë të jetë e mundur si dhe integrimin e ndricimit të kontrolluar i cili ndryshon në varesi të fluksit të dritës natyrore.

Gjate fazes së punimeve sidomos për mbetjet që janë demtuese të mjedisit e vecanerisht të bimesisë sic janë gelqerja, llaci, cimentoja etj do të pastrohen me kujdes nga e gjithë sipërfaqja e sheshit të ndertimit dhe do të transportohen për në vendin e grumbullimit të caktuar nga pushteti vendor.

Gjate ndertimit nuk do të ketë shkarkime të lengeta e të demshme që mund të filtrojnë në toke dhe të behen ndotes të ujërave nentokesore.

Gjate kohës së shfrytëzimit të objektit nuk krijohen demtime të tokës, pasi nuk ka mbetje të demshme që mund të shkarkohen në të, por janë vetëm mbetje të zakonshme urbane.

Do të behet nga firma sistemimi i territorit sipas projektit të paraqitur. Do të përcaktohet vendi për vendosjen e konteniereve për mbetjet urbane që do të gjenerohen gjatë aktivitetit human të perkohshëm.

Të gjitha materialet e përdorshme janë me veti të njohura e të zakonshme që nuk shkaktojnë demtime në mjedis sic janë paraqitur edhe në relacionin ndertimor.

Nuk do të kemi një teknologji/makineri të përdorur në objekt pasi nuk kemi të bëjmë me linjë prodhimi.

dh) të dhëna për infrastrukturën e nevojshme për lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, shkarkimet e ujërave të ndotura dhe mbetjeve, si dhe informacion për rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja:

Furnizimi me energji elektrike dhe ndricimi

